

**MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
PËR BASHKËPUNIM NDËRMJET
AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE
AKADEMISË SË DIPLOMACISË SË MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
TË REPUBLIKËS SË TURQISË**

Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Akademia e Diplomacisë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Turqisë pajtohen të nënshkruajnë Memorandumin e Mirëkuptimit në vijim me qëllim të thellimit të bashkëpunimit me dobi të ndërsjella për trajnim në fushën e diplomatikë dhe në shkëmbimin e informative në temat e së drejtës ndërkombëtare, të drejtës diplomatike si dhe disiplinave të tjera akademike që janë relevante për ushtrimin e diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, qofshin këto politike, ekonomike, kulturore, financiare apo të tjera.

NENI I

Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Akademia e Diplomacisë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Turqisë mund të ruajnë shkëmbim aktiv të informacionit mbi programet e tyre përkatëse studimore dhe veprimtaritë e tjera relevante akademike.

NENI II

Të dyja institucionet mund të lehtësojnë shkëmbimin e akademikëve, folësit e konferencave, ekspertët dhe hulumtuesit në fushat që janë në interesin e tyre të përbashkët. Të dyja institucionet mund të nxisin ligjërata dhe prezantime të ofruara veçanërisht nga zyrtarët e tyre në kuadër të programeve të tyre të trajnimit.

NENI III

Të dyja institucionet mund të konsultohen lidhur me mundësitë e organizimit të kurseve dhe seminareve të cilat mund të zhvillohet në mënyrë të ndërsjellë në Prishtinë dhe Ankara.

NENI IV

Të dyja institucionet mund të lehtësojnë shkëmbimin e publikimeve të tyre përkatëse, si dhe tekstet përkatëse nga institucionet e tjera publike ose private nga vendet e tyre përkatëse.

NENI V

Të dyja institucionet mund të shkëmbejnë informacion lidhur me veprimtaritë me interes të përbashkët, duke pasur veçanërisht parasysh pjesëmarrjen në takimet me karakter rajonal dhe ndërkombëtar, që përfshijnë akademitë dhe institucionet e tjera akademike që ofrojnë trajnime për diplomatë.

NENI VI


Secila palë përmbushë obligimet e ndërmarra sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse. Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk përbën ose nuk interpretohet si një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Shteteve të Palëve. Asnjë dispozitë e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit nuk interpretohet dhe zbatohet duke krijuar të drejta apo zotime të reja për Shtetet e Palëve.

NENI VII

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit dhe vlen për 3 vjet. Përveç nëse njëra nga palët e njofton palën tjetër me qëllimin e vet për të ndërprerë MM në formë të shkruar së paku 90 ditë para datës së skadimit, vlefshmëria e të njëjtit zgjatet për periudha tre vjeçare.

Nënshkruar në qytetin e Prishtinës, më datë 3 gusht 2012, në dy ekzemplarë origjinalë në gjuhën shqipe, serbe, turke dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëloj autentike. Në rast të kundërshtimit në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.


**PËR AKADEMINË DIPLOMATIKE TË
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**



Petrit SELIMI

**Zëvendësministër
Ministria e Punëve të Jashtme e
Republikës së Kosovës**

**PËR AKADEMINË E DIPLOMACISË SË
MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME
TË REPUBLIKËS SË TURQISË**



Ambasador Naci KORU

**Zëvendësministër
Ministria e Punëve të Jashtme e
Republikës së Turqisë**